



# NEWSLETTER E DIASPORËS

PERFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHITETET KU ATA BANOJNË

#97



## TAKIMI/ "Mjekët e Diasporës, protagonistët e kohës"



Në Tiranë u mbajt takimi i dytë i Mjekësisë në Diasporë, që për shkak të kushteve të pandemisë u zhvillua online me mjekët shqiptarë jashtë vendit. Takimi u organizuar nga Agjencia Kombëtare e Diasporës me mbështetjen e Ministrisë së Shtetit për Diasporën dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Në takim mbajtën fjalën e tyre përshëndetëse Ministri i Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko, Ministri i Shëndetësisë, Ogerta Manastirliu, dhe personalitete të njohur në fushën e shëndetësisë në vend dhe jashtë vendit.



**"Apliko online për rinovimim e dokumenteve biometrike"**

Të interesuarit për të drejtën e votës në migracion mund të marrin më shumë informacion në faqen e Web-it të Komisionit të Reformës Zgjedhore.

## VOTA E DIASPORËS/ KKD diskutime me KQZ dhe aktorët politikë në vend

Thirrjes publike të Këshillit Koordinues të Diasporës për zgjidhjen e ngërcit me procesin e votimit të Diasporës i janë përgjigjur të gjitha palët pjesëmarrëse dhe të interesuara.

Dhe pse është folur shpesh për afate, në takimin që zgjati për më shumë se tre orë, palët ranë dakord që në një tjetër mbledhje brenda kësaj jave të vendoset përfundimisht se çfarë do të ndodhë me votën e Diasporës.


Në takimin e kërkuar nga Këshilli i Koordinimit të Diasporës, krahas anëtarëve të saj ishin ftuar ministri i Shtetit për Diasporën Pandeli Majko, Kreu i KQZ, Ilirjan Celibashi, përfaqësuesi i partisë Demokratike, Oerd Bylykbashi, përfaqësues nga Avokati i Popullit, shoqata Germin, Lëvizja për Diasporën e lirë etj. Ata patën një diskutim "maratonë" mbi situatën aktuale të procesit dhe mundësinë reale të realizimit të votës së Diasporës në një periudhë kohore kaq të shkurtër.



## Vota e Diasporës Shqiptare

Të interesuarit për të drejtën e votës në migracion mund të marrin më shumë informacion në faqen e Web-it të Komisionit të Reformës Zgjedhore.

## PROJEKTLIGJI/ Diskutime në Kuvend për lehtësim të procedurave dhe rregullimin e kuadrit rregullator ligjor të Agjencisë Kombëtare të Diasporës



Komisioni Parlamentar për Politikën e Jashtme shqyrtoi sot në parim projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 115/2017 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës". Në mbledhjen e komisionit ishin të ftuar edhe Ministri i Shtetit për Diasporën, Z. Pandeli Majko, Drejtuesja Ekzekutive e AKD-së, Znj. Sonila Hysi dhe Drejtore e Diasporës, Znj. Klaudia Hasanllari.


Projektligji i propozuar nga deputeti Adnor Shameti dhe i konsultuar me Ministrin e Shtetit për Diasporën dhe Agjencinë Kombëtare të Diasporës synon kryerjen e disa shtesave dhe ndryshimeve në ligjin aktual, që lidhen me përmirësimin e kuadrit ligjor të Agjencisë Kombëtare të Diasporës, duke u mbështetur në zhvillimin e punës së Agjencisë dhe problematikat e hasura gjatë zbatimit të legjislacionit gjatë këtyre viteve të funksionimit.



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen

## Tekstet e përbashkëta/ Nis konkursi për tekstet e gjuhës shqipe në Diasporë

Pas firmosjes së urdhrat të përbashkët për miratimin e paketës së dokumenteve mbi procedurat e zhvillimit të konkursit të teksteve mësimore për Diasporën, kritereve për recensuesit e teksteve mësimore për Diasporën dhe shpalljen e konkursit për tekste mësimore për Diasporën mes ministrit të Arsimit dhe Shkencës të Kosovës z. Ramë Likaj, ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë znj. Evis Kushi dhe ministrit të Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko, Qendra e Botimeve për Diasporën dhe dy ministritë përgjegjëse për arsimin, Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Kosovës dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë e Republikës së Shqipërisë, publikojnë thirrjen për aplikim në konkursin për tekstin mësimor për mësimin plotësues të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Diasporë dhe në Mërgatë, me titullin "Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare" niveli I.



Connect Albania është një program që lehtëson angazhimin e Diasporës Shqiptare që jeton jashtë vendit në zhvillimin e vendit të tyre të lindjes si agjentë zhvillimi për të tërhequr dhe rritur investimet midis komuniteteve shqiptare dhe të huaja përmes mekanizmit online

## DISKUTIMI/ Remitancat dhe Diaspora në Greqi



Projekti "Greenback 2" i Bankës Botërore dhe organizata Germin organizuan takimi e radhë online, këtë herë me përfaqësues të Diasporës Shqiptare në Greqi, ku u diskutua mbi rëndësinë e remitancave të Diasporës dhe rrugët për t'i përdorur ato më me efektivitet në ekonominë e Shqipërisë.

Përfaqësuesit e Projektit të Bankës Botërore dhe Germin theksuan dobinë e bisedave të kësaj natyre, për të mundësuar ide dhe projekte për përdorimin e remitancave në ndihmë të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit.

## Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"



App store: [këtu](#) Play store: [këtu](#)

## **Digjitalizimi i Veprave Shqiptare**



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen

## **Dhuro Libra**



Nisma “Dhuro libra” do të shërbejë për krijimin e një fondi me libra shqiptarë në institucionet e vuajtjes së dënimit në Greqi dhe Itali.

**Për më shumë informacione nga Diaspora vizitoni  
[www.diasporashqiptare.al](http://www.diasporashqiptare.al)**